

**URDHËR**  
**Nr. 180, datë 15.6.2020**

**PËR NJOFTIMET E AKTEVE JASHTËGJYQËSORE NGA NOTERI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 134, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

**URDHËROJ:**

1. Komunikimi i një kujtese, deklarate a një dokumenti nga noteri, një personi tjetër, me telegrame, fakse e telefakse, kryhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë urdhër.

2. Komunikimi i një kujtese, deklarate a një dokumenti nga noteri, me telegram, faks ose telefaks, kryhet vetëm në rastet kur kërkohet për t’u njoftuar nga personi, posaçërisht nëpërmjet këtyre mjeteve ose kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë.

3. Në rastet kur komunikimi kryhet nëpërmjet këtyre mjeteve, noteri mban për këtë qëllim një procesverbal të posaçëm, ku tregohen:

- a) të dhënat e kontaktit të personit që merr komunikimin;
- b) të dhënat e kontaktit të personit i cili kërkon të kryhet njoftimi;
- c) të dhënat e adresës prej ku nisët njoftimi;
- ç) të dhënat e adresës që i drejtohet njoftimi;
- d) mjeti i përdorur për njoftim;
- dh) data dhe ora e saktë e komunikimit;
- e) personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit;

ë) kopje e fletës së regjistrimit nga pajisja përkatëse elektronike për dërgimin e mesazheve, që provon dërgimin e njoftimit në të dhënat e telegramit, faksit ose telefaksit të marrësit.

4. Në çdo rast, komunikimi i kryer me telegrame, fakse e telefakse, konsiderohet i marrë vetëm në rastet, kur personi ndaj të cilit i drejtohet njoftimi vërteton me shkrim, me shkresë dorazi e me mënyra të tjera, që garantojnë një njoftim të rregullt, marrjen e njoftimit.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen noterët.

6. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË**  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**

